Republika e Shqiperise
Dhoma e Notereve
Tirane
Nr. 998 Rep.
N. 96, Kol.

Tirane, me 25 maj 2004

Kontrate transferimi i pjeseve te kapitalit
(shitje kuotash)

Sot, me daten 25 maj 2004, para meje noteres Irena Laha, u paraqiten personalisht palet te cilat me kerkuan redaktimin e kontrates si me poshte :

**Shitesi** : **Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim, BERZH,** nje organizate internacionale me seli ne One Exchange Square, London EC2A 2JN, England / United Kingdom, perfaqesuar nga zoti Giulio Moreno, lindur me 19. 02. 1959, ne Rome, banues ne rr. Abdi Toptani, Drin Tower, kati 4, nenshtetas italian, me numer pashaporte B 252402, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar prej meje, me prokure te posaçme nr. G384756, te dates 01.04.2004, leshuar nga Mary Ellen Collins, noterizuar nga noteri publik Jeremy Brooker Burgess , ne Londer.

**Bleresi** : **Rogner International Hotels & Resorts GmbH,** nje shoqeri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjit austriak me seli ne 118 Breitenfurterstrasse, A-1230 Viene, Austri, perfaqesuar nga zoti Klaus Ressmann, lindur me 10 qershor 1941, banues ne Duerergasse 15, A-1060, Viene, Austri, nenshtetas austriak, me numer pashaporte J 0555123 3, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar prej meje, i pajisur me prokure te posaçme nr. 1832/ 2004, te dates 13.05.2004, leshuar nga Klaus Hofmann, noterizuar nga noteri publik Dr Peter Zdesar, ne Villach.

Te pergjithshme

A. Shitesi zoteron 2500 pjese kapitali ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e arte sh.p.k . », nje shoqeri qe ekziston sipas ligjeve shqiptare, regjistruar ne Gjykaten e rrethit te Tiranes, me 5 qershor 1993 me vendim numer 3709 / 1, me seli ne Bvd. Deshmoret e Kombit (Hotel Europark), Tirana, Albania, (« Shoqeria ») ;

B. Bleresi nuk ka zoteruar pjese te kapitalit te Shoqerise.

C. Te gjithe ortaket e Shoqerise kane miratuar, ne perputhje me nenet statutore te shoqerise, transferimin e 982 pjeseve te kapitalit nga Shitesi tek Bleresi, me ane te nje vendimi te asamblese te dates 7 prill 2004, dokument qe i bashkengjitet kesaj kontrate.

Palet bien dakort si me poshte :

1. Shitesi konfirmon qe eshte paguar plotesisht nga Bleresi, sipas çmimit te rene dakort me te. Si rrjedhim, ai transferon, ne pronesine e Bleresit, 982 pjese kapitali me nje vlere nominale prej 1000 (njemije) US Dollare secila, te zoteruara ne kapitalin e shoqerise « Shqiponja e arte sh.p.k . » . Shitesi garanton Bleresin qe 982 pjeset e transferuara te kapitalit te jane krejtesisht te lira nga çdo peng dhe barre.

2. Bleresi pranon pronesine e 982 pjeseve te kapitalit te mesiperm, te lira nga çdo peng dhe barre dhe pranon te gjitha te drejtat dhe detyrimet e ortakut te Shoqerise sipas statutit te Shoqerise.

3. Shitesi dhe Bleresi pranojne te zbatojne e t'i japin njeri tjetrit dhe/ose Shoqerise me kerkese te pales tjeter dhe/ose Shoqerise, te gjithe dokumentacionin e duhur ne pergjithesi, per te kryer çdo gje te nevojshme per transferimin e pjeseve te kapitalit, qe jane objekt i kesaj kontrate, dhe per ta regjistruar kete transferim ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit te Tiranes, si edhe ne cdo organ tjeter shqiptar sipas ligjeve shqiptare.

Kjo kontrate u perpilua ne 4 kopje me vlere te barabarte ligjore. Ajo ju lexua dhe ju perkthye paleve saktesisht, nga gjuha shqipe ne gjuhen angleze, nga perkthyesja Flonja Boriçi. Kontrata u pranua nga palet dhe u gjend sipas vullnetit te tyre te lire dhe te shprehur. Ajo u nenshkrua ne menyre te rregullt, nga palet, para meje, dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

Rogner International Hotels &Resorts GmbH, Bleresi

Emri : Klaus Ressmann

Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim, BERZH, Shitesi

Emri : Giulio Moreno

NOTER
IRENA LAKA

Taksa u pagua

Përkthyese
Flonja Borici

28